



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Proces verbal

Sot me datë 23.04.2026 ora 13:00 ishte parashikuar mbledhja e **Kryesisë së Këshillit Bashkiak** për shqyrtimin e rendit të ditës për mbledhjen e rradhës të Këshillit Bashkiak. Nga administrata e Bashkisë nuk kishte të pranishëm.

Të pranishëm janë:

Z. Oltion Luli
Znj. Irena Shala
Znj.Valjeta Bajraktari

Mungon:

Znj.Violeta Përndrecaj
Z.Gjergj Sokoli
Z. Edmond Ndou

Kourumi i domosdoshëm për zhvillimin e mbledhjes nuk është prezent, prandaj **Z.Luli** në cilësinë e Kryetarit vijon me citimin e rendin të ditës, që parashikohet për mbledhjen ardhshme të Këshillit Bashkiak, pjesë kjo që kryhet nga kryesia e Këshillit. Po ashtu vendoset edhe data e mbledhjes , e cila do të mbahet ditën e Mërkurë, datë 29.04.2026, me rend dite si më poshtë:

Miratimi i Procesverbalit të Mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak datë, 30.03.2026 sipas ligjit Nr.8480 datë, 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, neni 16 pika 2.

- 1. Projektvendim: “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Mars 2026”.*
- 2. Projektvendim: “Për dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri”.*
- 3. Projektvendim: “Për një ndryshim në VKB nr.6, datë 22.01.2020 , “Për rishikimin dhe miratimin e listave të pasurive pyje dhe kullota që ndodhen brenda territorit administrativ të Bashkisë Shkodër me propozimin për ndryshimin e VKM nr.433, datë 08.06.2016 “ Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive, kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Shkodër”.*
- 4. Projektvendim: “Për miratimin e shtesës dhe ndryshimit të planit në buxhetin e Bashkisë Shkodër të miratuar me VKB nr.84 datë 18.12.2025, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026*

dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar.

5. *Projektvendim: “Për një shtesë në VKB nr.84 datë 18.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar.*
 6. *Projektvendim: “Për miratim ndryshim plani në buxhetin e Bashkisë Shkodër të miratuar me VKB nr. 84 datë 18.12.2025, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar – për mbulimin e detyrimeve që rrjedhim nga projekti i miratuar me VKB nr. 16, datë 27.02.2026, “Shtëpia që ndërton të ardhmen – Rikonstruksion i Shtëpisë së Fëmijës (6-15 vjeç) ”.*
 7. *Projektvendim: : “Për një shtesë në buxhetin e vitit 2026 e VKB nr.84 datë 18.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar.*
- *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka, mbledhja e Kryesisë deklarohet e mbyllur.

SEKRETARE

Zbardhi procesverbalin:

Irma Sulishti

Sabina Danaj